



Republika e Kosovës  
Zyra e Kryeministrit  
Agjencia për Barazi Gjinore

## **Termet e Referencës**

### **për**

## **Trajnim për Punë Dore**

Projekti: **Fuqizimi dhe Rimekëmbja Ekonomike dhe të drejtat e grave të mbijetuara nga dhuna në baza gjinore dhe dhuna seksuale**

Aktiviteti 1.2: Zhvillimi i kapaciteteve

---

### **1.1. Prapavija**

Mbështetur nga Agjencia për Barazi Gjinore e Republikës së Kosovës, Medica Gjakova si organizatë partnere lokale, është përgjegjëse për implementimin e projektit "Fuqizimi dhe Rimekëmbja Ekonomike dhe të drejtat e grave të mbijetuara nga dhuna në baza gjinore dhe dhuna seksuale", projekt ky i bazuar në administrimin e ndihmës së Masës 10-të, për Programin e Rigjenerimit Ekonomik në Republikën e Kosovës.

### **1.2. Infomrta për projektin**

Kosova, posaqërsisht Rajoni i Dukagjinit është prekur nga papunësia e lartë dhe varfëria, veçanërisht në mesin e grave të mbijetuara të dhunës seksuale dhe vajzave (familjarët e tyre). Shumë prej tyre për shkak të stigmatizimit përballen me varfërinë, papunësin dhe diskriminimin përsëri e sidomos tani që për shkak të pandemisë Covid-19 gjendja ekonomike është rënduar tejmasë. Si një vend që ka përjetuar konflikt/luftë, dhuna në të gjitha format është përhapur shumë në Kosovë duke përfshirë edhe të rikthyerit. Projekti synon poashtu riintegrimin e qëndrueshëm të këtyre personave duke mundësuar kështu edhe fuqizimin dhe stabilizimin e Kosovës. Projekti do të ndihmojë përmes sektorit për fuqizim ekonomik (gjenerimit të të hyrave dhe zhvillimit të kapaciteteve), psikosocial (kshillimeve), gjinekologjik (kshillimeve dhe vizitave) dhe juridik (kshillimeve dhe asistences).

Grupi i targetuar i synuar do te jetë 130 persona të cilët janë gra/vajza të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë dhe të rinjë familjarë të tyre të cilët kanë përjetuar traumë ndër gjenerata. Deri në 10% do të jenë persona të rikthyer, veçanërisht gratë dhe pakicat etnike.

Grupi i ndikuar indirekt do të jenë familjarët e grupit të targetit që do të përfitojnë nga rritja e të ardhurave (rreth 1500 persona).

### 1.3. Aktivitetet

Ofruesi i shërbimeve është përgjegjës për sigurimin e trajnimeve për qepje dhe punë dore. Bazuar në produktet që gratë anëtare të shoqatës tashmë prodhojnë, por gjithashtu ofruesi i shërbimeve është përgjegjës që të jetë inovativ dhe në bashkëpunim me gratë të i mësojë ato dhe të prodhojë produkte inovative për prodhim dhe shitje.

Ofruesi i shërbimeve do të punoj ngushtë me partnerin lokal Medica Gjakova për të zhvilluar aktivitetet që vijojnë:

Aktiviteti 1: Ndhimë stafit të Medica Gjakovës për blerjen dhe përgatitjen e paisjeve, materialeve të trajnimit dhe vegla tjera të trajnimit dhe planifikimin e trajnimit,

Aktiviteti 2: Ofrimit të trajnimeve të përshtatura për gratë/vajzat e përzgjedhur nga Medica Gjakova bazuar në projekt;

Aktiviteti 3: Vlerësimi i trajnimit;

Aktiviteti 4: Mentorimi gjatë dhe pas trajnimit përgjatë kohëzgjatjes së projektit (shtator 2021);

### 1.4. Shërbimet

Ofruesi lokal i shërbimeve është përgjegjës për shërbimet në vijim:

- Regjistrimi i pjesëmarrësve të trajnimit;
- Format e vlerësimit të trajnimit;
- Ofrimi i trajnimeve për gratë/vajzat e zgjedhura;
- Raporti final brenda 15 ditëve të përfundimit të marrëveshjes përfshirë leksionet e mësuara, rekomandimet dhe përfundimet;

### 1.5. Orari

Marrëveshja duhet të përmbushet gjatë 2 muajve. Gjatë kësaj periudhe, ofruesi i shërbimeve do të kryejë detyrat e cekura më lartë.

### 1.6. Gjuha

Raporti final duhet të shkruhet në gjuhën angleze.

## 2. Vendi i marrëveshjes

Gjakovë, Republika e Kosovës.

## 3. Raportimi

- Dorëzimi i raportit final sipas marrëveshjes.
- Dorëzimi i fotove gjatë trajnimit dhe eventeve tjera.
- Raportimi dhe gjitha dokumentet vlerësuese duhet të kryhen në gjuhët e lartëpërmendura. Komentet dhe sugjerimet nga stafi i projektit nga MGJ (Medica Gjakova) duhet të mirren në konsideratë përgjatë marrëveshjes.

## 4. Prokurimi i pajisjeve dhe materialeve

Konsulenti është përgjegjës për të ofruar ndihmë stafit të Medica Gjakovës në blerjen dhe përgatitjen e materialeve të trajnimit dhe pajisjeve në përputhje projektin.

## 5. Dispozitat tjera

Buxheti i ofrimit të shërbimit nuk duhet të kalojë vlerën prej 750 EURO bruto. Për ofrimin e shërbimeve pagesa do të kryehet në dy këste.

## 6. Komunikimi

**Adresa: Fadil Nimani Nr.34 Gjakovë, Republika e Kosovës** [www.medicagjakova.org](http://www.medicagjakova.org)  
**fb:medicagjakova +383390326812**

Nëse keni pyetje shtesë në lidhje me Termat e References ose procesin e tenderimit, ju lutem kontaktoni përmes emailit: [medicagjakova@gmail.com](mailto:medicagjakova@gmail.com) ose [laura.qarkaxhija@gmail.com](mailto:laura.qarkaxhija@gmail.com) (menaxhere e projektit).

Afati i fundit për dorëzimin e propozimit/ofertës është 16.07.2021.

Ofertat elektronike të plotësuara duhet të dorëzohen përmes postës elektronike në [medicagjakova@gmail.com](mailto:medicagjakova@gmail.com) ose [laura.qarkaxhija@gmail.com](mailto:laura.qarkaxhija@gmail.com) (menaxhere e projektit).

Shënim: Ofertat e marra pas afatit dhe ofertat jo të plota nuk do të mirren parasysh.